



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 27

Datë: 10. 06. 2020. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.24/2020.

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

• **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës për kandidatët e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të ZRPPC-së për Partitë Politike që nuk kanë dorëzuar formularin e vazhdimit të regjistrimit;

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Krvesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.24/2020

Valdete Daka: Përshëndetje, e hapi mbledhjen e 27 –të. A ka dikush diçka, përpara se ta miratojmë rendin e ditës...?

(Para se të miratohet rendi i ditës, anëtarët e KQZ-së diskutuan dhe debatuan lidhur me bashkëpunimin, koordinimin dhe çështjet tjera që lidhen me aktivitetet e brendshme të KQZ-së, aspektet e përpilimit të rendit të ditës të mbledhjeve, zgjedhjet lokale të pezulluara për shkak të pandemisë në Podujevë etj. Diskutuan: Alim Rama, Valdete Daka, Sami Kurteshi, Sami Hamiti dhe, Arianit Elshani, Čemailj Kurtiši, Eshref Vishi, dhe Arianit Elshani.

Në fund të këtij debati të gjatë, i cili nuk është zhvilluar mbi bazë të pikave të rendit të ditës, kryetarja znj. Daka, kërkoi, kërkoi ekskluzivisht që të ndërpritet ky debat i gjatë, dhe eventualisht, nëse ka propozim të ndokujt të ndonjë pike që të futet në rendin e ditës, përmes votimit të anëtarëve të KQZ-së.

Anëtari i KQZ-së, Sami Kurteshi propozoi që si pikë të rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të jetë, “Diskutimi për zgjedhjet...”)

Valdete Daka: Ju lutem, ta votojmë rendin e ditës. Kush është për..? Me 10 vota për, dhe 1 votë kundër (Alim Rama), u miratua rendi i ditës.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nga mbledhja nr.24/2020, e KQZ –së, me vërejtje nga anëtari, Eshref Vishi.

2.Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës për kandidatët e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Arianit Elshani: Këshilli, në takimin e fundit ka shqyrtuar rekomandimin për zyrën e Presidentit për zëvendësimin e kandidatëve të radhës të deputetëve të Kuvendit të

Republikës së Kosovës. Pasi që ne kemi analizuar gjithë rregullat ligjore, dhe të gjithë filtrat e nevojshëm, rekomandojmë këto zëvendësime të cilat, i keni.

Valdete Daka: E kemi materialin dhe rekomandimin për zëvendësimin e kandidatëve të radhës për deputet. Atëherë:

z. Visar Hoti është kandidat i radhës që e zëvendëson deputetin e deritashëm, z. Driton Selmanaj.

z. Ismet Beqiri, është kandidat i radhës që e zëvendëson deputetin e deritashëm, z. Arban Abrashi.

z. Faton Bislimi, është kandidat i radhës që e zëvendëson deputetin e deritashëm, z. Armend Zemaj.

Këta tre deputet, vijnë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ndërsa:

z. Arbëreshë Krasniqi, është kandidat i radhës që e zëvendëson deputeten e deritashme, Albulena Bala – Halimit nga subjekti politik Nisma për Kosovën – Aleanca e Re – Partia e Drejtësisë.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto zëvendësime

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të ZRPPC-së për Partitë Politike që nuk kanë dorëzuar formularin e vazhimit të regjistrimit:

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar raportin e ZRPPC-së për Partitë Politike që nuk kanë dorëzuar formularin e vazhimit të regjistrimit, dhe rekomandon c’regjistrimin e këtyre partive që kanë dështuar t’i dorëzojnë formularët e regjistrimit, pavarësisht afatit të shtyrë...

Valdete Daka: Pra, e kemi rekomandimin. Është: Evropska Stranka Demokratske Akcije (ESDA), Samostalna Liberalna Stranka (SLS), Partia Euroatlantike e Kosovës (PEK), Lëvizja për Drejtësi (LD). Pra, këto parti të c’regjistrohen nga Regjistri i Partive Politike në ZRPP.

Kush është për...?

Sami Kurteshi: Vetëm ta sqarojmë: z. Elshani ka udhëhequr mbledhjen, dhe rekomandimi është marrë me një analizë të thellë. Nuk ka pengesë që nuk e kemi

shqyrtuar, por më duket se mbi çdo bazë etike dhe ligjore, këto subjekte nuk janë përgjigjur...

Arianit Elshani: Janë shqyrtuar të gjitha mundësitë, mjetet dhe hapësira ligjore që të kalojmë deri te ky rekomandim, pra që edhe të jemi korrekt me këto subjekte, mirëpo nuk kemi pasur mundësi tjera dhe, është rekomanduar që këto parti të c'regjistrohen...Madje, edhe komunikimet, i kemi vendosur në dosje...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë rekomandim.

3.Të ndryshme

Sami Kurteshi: Kam një rekomandim. Ne, mbledhjen e kaluar, e kemi diskutuar çështjen e Komitetit të Auditimit, madje edhe në mbledhjet e kaluara. Unë, meqë kemi vështirësi të sigurimit të auditimit, kam biseduar me një auditor të Avokatit të Popullit, dhe ai ka pranuar. Por, kjo gjë të shkojë në vija zyrtare, ishtitucionale, domethënë Sekretariati të veproj mbi baza ligjore - zyrtare...

Eshref Vishi: Na kemi marrë vendim që Komiteti të Auditimit të jetë prej 5 vetave, kushtet ligjore janë 3 të jashtëm, na e diskutuam edhe çështjen e komunikimit me auditorë n'takimin q'i patum, do t'ishte mirë që t'vejmë komunikim me auditortë e institucioneve tjera, që t'i bashkangjiten komitetit të auditimit të KQZ-së, mirëpo janë edhe kushtet ligjore që një auditor i një institucioni në dy komitete të auditimit, domethënë, nëse auditori i institucionit që e përmendni ju asht i angazhum në një tjetër ai nuk do t'ketë mundësi, mirëpo ne duhet t'komunikojmë...

T'gjitha propozimet, le t'shkojnë te ushtruesi i detyrës së Kryeshefit t'Ekzekutivit, më pas ne do t'shkojmë drejt konstituimit të k'tij komiteti...që është edhe interesi i institucionit tonë që t'bahet funksional ky komitet.

